REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 22.09.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014"Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se:

- **Sa është numri total i vendeve të parkimit të parashikuara në skemën e parkimit në territorin e Bashkisë Durrës dhe si ndahen ato sipas kategorive?** Ju lutemi të specifikoni numrin dhe përqindjen e vendeve me pagesë, pa pagesë, për rezidentët dhe për kategoritë e tjera të parashikuara.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.66 datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, janë të miratuara sheshet e destinuara për parkim me pagesë si dhe zonat e reja të destinuara për parkim me pagesë në rrugë (Zona A dhe B) me tarifat respektive. Aktualisht janë 16 rrugë dhe 3 sheshe, shtrirë në dy zona (Zona A dhe Zona B) dhe kategoritë e ndarjes së tyre në gjurmët mbi të cilat zhvillohett projekti si më poshtë vijon:

Nr.Total i vend parkimeve: 3487 , nga të cilat

Vende parkimi **me pagesë**: **3080,**

Vende parkimi të PAK: **157 (pa pagesë)**

Vende parkimi të rezervuara për subjekte: **108 (me pagesë)**

Vende parkimi të taksive: **142 (me pagesë)**

Në këtë vendim gjithashtu janë parashikuar dhe parkimet për kategoritë e e rezidentëve ku citohet konkretisht :

‘ Miratimin e parkimit pa pagesë për rezidentët në hapësirat publike midis pallateve në të gjithë territorin administrativ të bashkisë Durrës përfshirë edhe zonën A dhe B’.

Në vitin 2026, Bashkia Durrës ka marrë masa për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues të Institucionit , Policisë Bashkiake dhe Ndërrmarjes Rruga , me qëllim verifikimin e gjëndjes faktike në terren lidhur me numrin e vendparkimeve të mundshme të lira krahasimisht me numrin e tyre të përcaktuar në VKB nr.66 datë 25.06.2024, për hapjen rrugë të zhvillimit të projektit për rruget dhe sheshet.
Bashkelidhur gjeni procesverbalin e datës **17.03.2026** të grupit të punës sa më lart cituar **,** ku janë te pasqyruara në formë tabelare , për secilin aks rrugor dhe sheshet respektivisht numri i: **parkimeve me pagesë në rrugë** (numri i mundshëm i vendosjes së tyre); **parkimeve taksi** (të miratuara me vendim te këshillit bashkiak), **parkimeve të rezervuara për subjektet private** (të miratuara nga Institucioni Bashkia), **parkimeve të personave me aftësi të kufizuar** etj.

- **Mbi çfarë kriteresh është përcaktuar shtrirja e zonave të vijëzuara me ngjyrë blu dhe ndarja e tyre në territorin e qytetit?** Ju lutemi të na vini në dispozicion hartën e plotë dhe të përditësuar të zonave dhe vendeve të parkimit.

Duke u bazuar në karakteristikat funksionale të secilës zonë , janë propozuar rrugët e destinuara për parkim në rrugë , ku :
Zona A: Përfshin vendndodhjet me ngarkesën më të madhe me ndërveprime intensive tregtare, financiare, institucionale apo sociale. Një pjesë e rrjetit rrugor të kësaj zone mban/përcjell aktivitetin e Administratës publike, qëndrat e biznesit, bankat, institucionet kulturore dhe artistike, aktivitetin turistik, atraksionet arkeologjike, lokalet dhe njësitë e shërbimit.

Zona B: Përfshin vendndodhjet ku mbizotërojnë shkëmbimet tregtare, financiare, institucionale, me intensitet mesatar.

Bashkëlidhur gjeni VKB nr.66 datë 25.06.2024 (i ndryshuar), ku në ANEKSIN nr.2 gjeni hartat e zonës së administrimit të parkimit të qytetit të Durrësit.

- **A është realizuar studim fizibiliteti, studim trafiku apo analizë teknike dhe ekonomike për skemën e parkimit me pagesë?** Nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion dokumentacionin përkatës.

Propozimi i zonave të administrimit të parkimit si dhe i tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe është bërë sipas vlerësimeve të grupit përkatës të punës të ngritur nga Institucioni i Bashkisë Durrës për këtë qëllim.

- **Si do të realizohet konkretisht mbledhja e tarifës së parkimit?** Ju lutemi të specifikoni mënyrat e pagesës, institucionin apo subjektin që do të administrojë sistemin dhe mënyrën se si do të kryhet kontrolli i pagesave.

Në lidhje me mënyrat e pagesës, tabelat e informimit e sqarojnë qartë si veprohet nga subjektet që parkojnë me pagesë: Oraret e tarifimit, Zona dhe tarifa përkatëse, Nr.Tel ku dërgohet një SMS me tekst targën e mjetit dhe zonën ku parkohet.

- **Çfarë skeme është parashikuar për rezidentët e zonave ku zbatohet parkimi me pagesë?** A do të kenë vende të dedikuara, parkim pa pagesë apo tarifa të reduktuara dhe cilat do të jenë kriteret për përfitimin e statusit të rezidentit?

Për sa i përket rezidentëve ku do të zbatohet parkimi me pagesë në rrugë, në këtë VKB është përcaktuar konkretisht:

‘***Miratimi i tarifës fikse vjetore prej 10.000 lekë përsa i përket parkimit të rezidentëve në zonën A dhe B, për të drejtën e parkimit në rrugët e destinuara për parkim publik me pagesë brenda njësisë administrative ku janë rezident, vetëm për një automjet**.’*

Duke paguar tarifën vjetore, rezidentët do të pajisen me një “Vërtetim abonimi për rezident” , sipas së cilit do të përjashtohen nga pagesa e tarifës së propozuar për parkimin me pagesë në rrugë, në varësi të kohës së qëndrimit. Ky abonim vlen për rezidentët të cilët aplikojnë për tu pajisur me “Vërtetim abonimi për rezident” , vetëm për rrugët e destinuara për parkim me pagesë të cilat ndodhen brenda njësisë administrative ku ato janë rezident.

- **Kur parashikohet të nisë zbatimi i plotë i skemës së parkimit me pagesë?** A ka përfunduar aktualisht procesi i vijëzimit dhe vendosjes së sinjalistikës në të gjitha zonat e përfshira në skemë?

Ndërmarrjes Rruga, aktualisht është në procesin përfundimtar të kontrollit të sinjalistikës së plotë rrugore për parkimet me pagesë, horizontale dhe vertikale (vijëzim dhe tabela informimi).

- **Sa vende parkimi pa pagesë do të mbeten në zonat ku aplikohet parkimi me pagesë dhe si është përcaktuar raporti ndërmjet parkimit me pagesë dhe atij pa pagesë?** Ju lutemi të na vini në dispozicion edhe vendndodhjen e hapësirave të parashikuara për parkim pa pagesë.

Me VKB nr.66 datë 25.06.2024 janë të miratuara si zona parkimi me pagese në rrugë vetëm këto akse :

ZONA A:

1. Rruga “Taulantia” (segmenti 2)
2. Rruga e “Currilave”
3. Bulevardi “Epidamn”
4. Bulevardi “Dyrrah”
5. Rruga “Egnatia”
6. Rruga “Mars 91”
7. Rruga “Aleksandër Goga” (segmenti 1)
8. Rruga e “Dëshmorëve”
9. Rruga “Adria”
10. Rruga “Pavarsia”
11. Rruga “Hafiz Ali Pogdorica”

ZONA B:

1. Rruga “Aleksandër Goga”
2. Rruga “Mujo Ulqinaku”
3. Rruga “Stefan Kaculini”
4. Rruga “Glaukia”
5. Rruga “Hysen Kërtusha”

Pjesa tjetër e segmenteve rugore të qytetit, nuk përfshihen në zonat e parkimit me pagese sipas VKB-se nr.66 datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës.

Gjithashtu: Jashtë fashës orare të tarifimit edhe në këto rrugë lejohet parkimi pa pagesë

- **Sa është kostoja totale e parashikuar për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të parkimit me pagesë**, përfshirë vijëzimin, sinjalistikën, pajisjet dhe sistemet e pagesës dhe kontrollit? Ju lutemi të specifikoni edhe burimin e financimit.

Për sa i përket projektit mbi vijëzimet dhe plotësimin e 16 akseve dhe 3 shesheve, miratuar me VKB nr.66 datë 25.06.2024 dhe I zbatuar aktuaisht, burimi I fondit prej 10.667.918 lekë pa tvsh ka qenë buxheti i Bashkisë Durrës dhe vlera e kontratës fituese ka qenë 8.060.700 lekë pa tvsh.